

Thirrje për pjesëmarrësit
Rrjetit të ndërgjegjësimit ndaj radikalizimit në Ballkanin Perëndimor
Vizitën studimore për gratë që kthehen nga territori i Daesh-it
18-19 shtator 2023, Prishtinë (Kosovë*)

Ne jemi duke kërkuar pjesëmarrës që janë të interesuar që të marrin pjesë në **vizitën e ardhshme studimore për gratë që kthehen nga territori i Daesh-it të Rrjetit të ndërgjegjësimit ndaj radikalizimit në Ballkanin Perëndimor**, e cila do të realizohet më **18-19 shtator të vitit 2023 në Prishtinë (Kosovë*)**.

Audienca kryesore e synuar e kësaj ngjarje rajonale përbëhet nga praktikuesit e P/LEDH në terren që punojnë me gratë e kthyer në Ballkanin Perëndimor dhe ata që kanë një fokus të veçantë në punën me gratë dhe nënat në punën e tyre. Kjo përfshin OSHC-të, punonjësit e daljes, të rinjtë dhe punonjësit social

Sfondi dhe qëllimi i takimit

Kosova* ka numrin më të madh të të kthyerve – individë që kthehen nga territori i kontrolluar nga Daesh – në krahasim me numrin e banorëve. Si një nga vendet e para që Kosova* vendosi në vitin 2019 të riatdhesojë në mënyrë aktive një numër më të madh të luftëtarëve të huaj terroristë (LHT) dhe familjet e tyre, duke i pritur ata në një mjedis të strukturuar mirë ku u krijua një qasje e koordinuar prej shumë-agjencish, duke vlerësuar rrezikun dhe nevojat e të kthyerve.

Në vitet e fundit RAN është përqendruar gjerësisht në temën e të kthyerve (femra) dhe familjeve të tyre në mjediset e Ballkanit Perëndimor, duke filluar në dhjetor të vitit 2019 me vizitën studimore të RAN KE ‘[Gratë dhe fëmijët e kthyer – Studimi i një përvoje të vazhdueshme në terren](#)’, dhe më së fundmi në dhjetor të vitit 2021 u realizua një në uebinar nga RAN në BB ‘Kthimi i LHT-ve dhe familjet e tyre’, në studimin ad hok të gushtit 2022 ‘[Trajtimi i grave të kthyer në Ballkanin Perëndimor: sfidat dhe mundësitë nga perspektiva e një praktikuesi](#)’ dhe në tetor të vitit 2022 u realizua një takim i shkallës të vogël nga RAN në BB ‘[Mbështetja e familjeve të lëna pas](#)’.

Kanë kaluar disa vite nga ky riatdhesim në shkallë të gjerë, i cili mundëson një vizitë studimore pasuese, duke shqyrtuar situatën aktuale në Kosovë*, veçanërisht kur bëhet fjalë për trajtimin e grave dhe fëmijëve të kthyer. Rrjedhimisht, më 18-19 shtator RAN në Ballkanin Perëndimor do të organizojë një vizitë studimore në Prishtinë me 15 praktikues nga Ballkani Perëndimor dhe BE. Kjo vizitë studimore do t'i kushtojë vëmendje të veçantë rolit që mund të luajë amësia në proceset e P/LEDH dhe shkëputjes, dhe synon t'u përgjigjet pyetjeve të mëposhtme:

- Cila është gjendja aktuale e femrave të kthyer në Kosovë* dhe fëmijëve të tyre?
 - Sa gra janë ende të burgosura, sa janë liruar?
 - Çfarë ka ndodhur me fëmijët e tyre?
- Si perceptohen gratë e kthyer dhe fëmijët e tyre në shoqërinë kosovare?
- Si ndikon pozita e përgjithshme e grave në shoqëri në këtë perceptim?
- Cili është ose mund të jetë roli i nënave në P/LEDH?
- Si mund të shfrytëzohet më së miri amësia e grave të kthyer si një faktor mbrojtës në procesin e tyre të shkëputjes dhe rehabilitimit?
- Si të përfshihen nënat e individëve që janë kthyer nga territori i Daesh-it në procesin e shkëputjes së fëmijëve të tyre?

Informata praktika:

- Nëse jeni të interesuar të merrni pjesë në këtë takim, ju lutemi [plotësoni formularin](#) më së voni deri në **18 gusht**.
- **Do të ketë në dispozicion interpretimi në gjuhët e Ballkanit Perëndimor.**
- Vizita studimore do të jetë një takim që fillon me drekë në datën 18 shtator dhe përfundon me drekë në datën 19 shtator. Pjesëmarrësit do të udhëtojnë në Prishtinë në 18 shtator dhe do të kthehen në shtëpi më 19 shtator.
- Hoteli, udhëtimi, dreka në të dy ditët dhe një darkë për rrjetëzim në ditën e parë të takimit janë të mbuluara nga RAN.

Nëse keni ndonjë pyetje në lidhje me takimin, ju lutemi kontaktoni anëtarët e stafit të RAN Fenna Canters (f.canters@radaradvies.nl) dhe Wim Klei (w.klei@radaradvies.nl).